



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 4 dhe 6 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, Vendimit për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-45612 i datës 12.11.2014 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 10. 2016, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës, miratojë këtë

**VENDIM
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE
BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN**

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **11.000,00€**, (njëmbëdhjetë mijë e euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 100 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur prej datës 22.06.2016 deri më 13.10.2016 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 100 = 11.000,00€$,

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 4

Ky Vendim është i hartuar në tri kopje origjinale

15.Nr. 400-61120
Lipjan, me 31. 10. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**KRYESUESJA
Vlora Limani – Hajnuni**

